



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE TË KZAZ NR. 02, 04, 05, 72, 77, DHE  
SEKRETARËVE TË KZAZ NR. 03, 05, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Lirim dhe emërimin e disa anëtarëve të KZAZ nr. 02, 04, 05, 72, 77 dhe të sekretarëve të KZAZ nr. 03 dhe nr. 05, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

**V Ë R E N**

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

- me shkresën nr. 7202, datë 05.06.2019:
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 02, z. Brian Muriqi dhe emërim të z. Erion Fiqret Mandi, Bashkia Shkodër;
- lirim të sekretarit të KZAZ nr. 03, z. Andi Bilali dhe emërim të Z. Arbër Jubica, Bashkia Bashkia Shkodër;
- lirim të anëtarëve të KZAZ nr. 04, z. Mirsad Mandija dhe z. Elson Çeliku, emërim në vend të tyre të zj. Irisa Ymeri dhe Antonio Matia, Bashkia Shkodër;



- lirim të anëtarëve të KZAZ nr. 05, z. Endrit Zaimaj z. Jozefin Daci, dhe sekretares zj. Elidona Ukcama, emërim në vend të tyre të z. Valentin Nikolli, Luçian Pjetri, dhe ne pozicionin e sekretarit të z. Ilir Dibra, Bashkia Shkodër;
- lirim të anëtarëve të KZAZ nr. 72, zj. Ada Rapo, emërim në vend të saj të zj. Anduela Fejzulla, Bashkia Korçë;
- me shkresën nr. 7812, datë 05.06.2019:
- lirim të sekretarit të KZAZ nr. 77, zj. Kleona Bahja dhe emërim të zj. Aleksandra Kaba, Bashkia Tepelenë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesat dhe propozimet e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, e gjen në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

### **V E N D O S I:**

1. Të lirojë nga detyra anëtarët e KZAZ-ve nr 02, 04, 05, 72, 77 dhe sekretarët e KZAZ-ve nr. 03 dhe nr. 05, sipas lidhjes 1.
2. Të emërojë anëtarët e KZAZ-ve nr. 02, 04, 05, 72, 77 dhe sekretarët e KZAZ-ve nr. 03 dhe nr. 05, sipas lidhjes 2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

